



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202000017/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda : Rekomandime për inspektimin e kryer në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.

Drejtuar : Drejtues i Parë Rebani JAUPI
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë

TIRANË

Për dijëni: Drejtues Madhor Ardi VELIU
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

I nderuar z.Jaupi,

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar,¹ bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.

Inspektimi i krye në datën 22.11.2019, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit të inspektimit mori pjesë znj. Ermonela Xhafa, Komisionere e Mekanizmit Kombëtar, znj. Jorida Rustemi, Këshilltare e Avokatit të Popullit dhe z. Besnik Deda me detyrë Nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

¹ Neni 74/1 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me z.Rebani Jaupi, Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, si dhe me z.Dhimitraq Ziu, zv/drejtor për sigurinë publike pranë kësaj drejtorie, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Më tej, zv/drejtori për sigurinë publike informoi grupin e inspektimit mbi gjendjen e kushteve në të cilën ndodhen ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë pranë kësaj drejtorie, angazhimin e drejtuesve dhe punonjësve të policisë të drejtorisë në respektimin dhe garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në këto ambiente në zbatim të akteve ligjore e nënligjore dhe atyre ndërkombëtare, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Pasi mori informacionin e nevojshëm, grupi i inspektimit vijoi takimin me shefin e dhomave të sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, punonjësit e policisë në zyrën e informacionit dhe të shërbimit në dhomat e sigurisë, si dhe inspektoi në vend gjendjen e kushteve në ambientet e shoqërimit dhe ato të sigurisë.

Grupi i inspektimit vizitoi zyrat e punonjësve të policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar, verifikoi dokumentacionin ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, si dhe mënyrën e plotësimit të tyre sipas rubrikave.

Gjithashtu, grupi i inspektimit zhvilloi intervista konfidenciale me personat e ndaluar/arrestuar që ndodheshin në mjediset e policisë në momentin e inspektimit.

Nisur nga kqyrja e kushteve materiale e fizike të dhomave të shoqërimit dhe dhomave të sigurisë, mënyra e plotësimit dhe administrimi i dokumentacionit që mbahet nga punonjësit e policisë, evidentohet fakti se mjedisi i shoqërimit dhe ai i sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, kryesisht janë të ndërtuara sipas kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në procedurat standarde të parashikuara në aktet normative dhe dokumentat ndërkombëtare, për këtë qëllim.

Gjatë inspektimit, u verifikuan me prioritet edhe zbatimi i rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi mëparshëm, nga i cili rezultoi se:

- **Ishte plotësuar rekomandimi**, për evidentimin dhe regjistrimin e të dhënave të personave të shoqëruar sipas rubrikave në “Regjistrin e evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar”, si dhe evidentimi i saktë i orës kur i privohet liria personit të shoqëruar në regjistrin dhe procesverbalin e shërbimit.
- **Ishte plotësuar rekomandimi**, për vënien në punë të sistemit të ngrohjes/ftohjes në dhomat e sigurisë dhe funksionimi i nyjes së dushit me ujë të ngrohtë për larjen e trupit të personave të arrestuar/ndaluar.
- **Ishte plotësuar rekomandimi**, për vënien në punë të telefonit fiks që ndodhet në koridorin e dhomave të sigurisë i cili shërben për komunikimin e punonjësve të shërbimit me zyrën e informacionit, si dhe butoni me zile/sinjali që ndodhet i instaluar në muret brënda dhomave të sigurisë dhe shërben gjithashtu për kontaktin e të arrestuarve/ndaluarve me punonjësin e policisë në rast nevojë.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

- **Nuk ishte krijuar në ambientin e shoqërimit**, dhoma(zyra) për marrjen në pyetje/ intervistimin e personave të ndaluar/arrestuar nga oficerët e policisë gjyqësore, para se ata të dërgohen në ambientet e sigurisë, si dhe monitorimi i saj me sistemin e kamerave.
- **Nuk ishte miratuar shtimi në organikë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë të Shtetit**, i një mjeku të përgjithshëm me kohë të plotë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, pasi prezenca vetëm e një mjeku/ndihmësmjeku për drejtorinë dhe të gjitha komisariatet në varësinë e saj është e pamjaftueshme.

Në përgjigje të raportit dhe rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në përfundim të inspektimit për vitin 2018, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresë nr.883/1 prot., datë 11.03.2019 na ka informuar se, këto rekomandime janë vlerësuar të drejta dhe do mbahen parasysh në projektin e ri që po zbatohet për ndërtimin e godinës/bllokut më vete të dhomave të sigurisë, për strukturat e drejtorisë/komisariatet e policisë Tiranë.

Vlen të theksojmë se, gjatë kryerjes të inspektimit në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë të kësaj drejtorie, punonjësit e policisë në të gjitha nivelet, u treguan bashkëpunues dhe transparentë me grupin e inspektimit.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre.

Ambienti i shoqërimit në Drejtorinë Vendore të Policisë, Tiranë, ishte i ndërtuar sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar dhe procedurën standarde "*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016.

Në ambientin e shoqërimit ndodhen 3(tre) dhoma shoqërimi të ndara më vete për personat e rritur, femra dhe të mitur. Dhomat e shoqërimit janë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme dhe të pajisura me karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, në përputhje me kapacitetin fizik të dhomave në total 15 persona të shoqëruar.

Dritaret e dhomave janë me përmasa të tilla që lejonin mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral. Në pjesën e jashtme, dritaret janë të siguruara me skarë të hollë hekuri, me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise.

Ambienti i shoqërimit kishte ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik. Dhomat dhe mjediset e tjera të shoqërimit ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, por ato kishin nevojë për lyerje me bojë, për shkak se personat që qëndrojnë në këto ambiente kishin dëmtuar muret e brendshme të dhomave.

Ngjitur me dhomat e shoqërimit, ndodheshin 2(dy) tualete të ndara më vete për femra dhe meshkuj.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në ambientin e shoqërimit mungonte dhoma (zyra) për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar. Marrja në pyetje dhe kryerja e veprimeve procedurale për verifikimin e shkakut të shoqërimit, si dhe komunikimi i masës së sigurisë për kalimin e personave nga dhomat e shoqërimit në dhomat e sigurisë, bëhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Këto zyra nuk janë të monitoruara me sistemin e kamerave.

Në të gjitha mjediset dhe në dhomat e ambientit të shoqërimit, grupi i inspektimit nuk gjeti sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve të të shoqëruarve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, ambienti i sigurisë ishte i ndërtuar në përgjithësi sipas kushteve dhe standardeve për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, sikurse përcaktohen në procedurën standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Ambienti i sigurisë kishte 8 (tetë) dhoma sigurie, të destinuara 6 (gjashtë) dhoma për meshkuj madhorë, 1 (një) për femra dhe 1 (një) për të mitur. Kapaciteti fizik i dhomave të sigurisë është për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e 10 (dhjetë) personave të arrestuar/ndaluar. Hapsira dhe sipërfaqe e çdo dhome ishte e bollshme për të përballuar kapacitetin zyrtar të dhomave dhe të ndërtuara sipas kriterëve të përcaktuara në procedurat standarde. Gjithashtu, ato ishin të kompletuara me orënditë e nevojshme si krevat hekuri të fiksuar në dysheme, dyshekë për çdo person, jastëk dhe batanije sipas normativave.

Gjatë inspektimit, në dhomat e sigurisë ishin të akomoduar 12(dymbëdhjetë) persona të ndaluar/arrestuar, nga të cilët 10(dhjetë) ishin meshkuj në moshë madhore dhe 2(dy) femra. Në dhomat ku ishin akomoduar personat e rritur, grupi i inspektimit konstatoi mbipopullim, pasi 6(gjashtë) prej tyre flinin në krevatë ndërsa 4(katër) personat e tjerë flinin me dyshekë të vendosur në dysheme.

Raporti me rekomandime i CPT (European Committee for the Prevention of Torture/Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës) gjatë vizitës inspektuese në Shqipëri në vitin 2018² e konsideron problematike kapacitetin e ulët që ofrojnë ambientet e sigurisë në DVP Tiranë, pasi ai është i pamjaftueshëm veçanërisht në rastet kur ka patur fluks të madh personash të ndaluar dhe të shoqëruar nga punonjësit e policisë të drejtorisë/komisariatet e policisë Tiranë.

Në rekomandimet e lartpërmendura përcaktohet qartë se, ambjentet e sigurisë që ndodhen në drejtorinë/komisariatet e policisë Tiranë, duhet të ndërtohen dhoma sigurie ku sipërfaqe e tyre të jetë jo më pak se 5m² për person. Ndërkohë, ekspertët e MKPT të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vizitave tematike të kryera në vitin 2019 në ambjentin e sigurisë të DVP Tiranë, kanë konstatuar se në disa raste në këto ambjente janë akomoduar edhe 7-8 persona në një dhomë, siç ishte rasti i ndalimeve të kryera pas protestave dhe ngjarjeve të tërmetit të ndodhura gjatë vitit 2019.

Koha e qëndrimit në dhomat e sigurisë të personave me masë sigurie “arrest me burg”, në bazë të urdhërit të lëshuar nga organi i prokurorisë, është deri në 96 orë brenda afati ligjor

² Raporti CPT për Shqipërinë botuar më 17 shtator 2019.

për vleftësimin e masës të sigurisë nga ana e gjykatës. Ndaj, qëndrimi i gjatë dhe në kushte të vështira akomodimi, përbëjnë trajtim çnjerëzor dhe degradues të këtyre personave.

Gjithashtu, grupi i inspektimit konstatoi një problematikë që ekziston ende me personat e ndaluar nga organi i policisë, të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata apo që kanë masë sigurie “arrest me burg”, të cilët duhet të qëndrojnë në ambientet e sigurisë të DVP Tiranë, deri në përgjigje të kërkesës drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Nga verifikimi i disa praktikave, u konstatua se kërkesat nga ana e organit të policisë kryhej menjëherë brenda ditës, me përfundimin e procedurave të verifikimit nga ana e tyre. Ndërkohë, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve kishte vonesa për transferimin menjëherë të këtyre personave në IEVP, sikurse përcaktohet në Kodin e Procedurës Penale. Ky, përbënte një shqetësim për Drejtorinë/komisariatet e policisë të Tiranës, pasi ka patur raste që personat kanë qëndruar deri dhe një javë në ambientet e sigurisë të kësaj drejtorie, duke bërë shkak për mbipopullime në këto dhoma sigurie.

Kjo praktikë është gjetur shkelje dhe është evidentuar në raportin e CPT (European Committee for the Prevention of Torture/Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës) të Këshillit të Europës, gjatë vizitës të fundit monitoruese të mbajtur nga data 20 deri 30 Nëntor 2018 në Shqipëri dhe botuar në 17 Shtator 2019.³

Në këtë raport, rekomandohet se *“Autoritetet shqiptare duhet të bëjnë përpjekje për t'i dhënë fund praktikës së mbajtjes në arrest policor të personave me masë sigurie “arrest në burg” dhe të dënuarit me burgim me një vendim të formës së prerë”*.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, institucionet shtetërore përgjegjëse Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 897/3, datë 04.03.2019 dhe nr. 2194, datë 05.03.2019 “Për transferimin në IEVP të të ndaluarve me masën e sigurisë “paraburgim” dhe të dënuarit me burgim me vendim të formës së prerë në mungesë, ku përcaktohen procedurat dhe afatet për transferimin e këtyre personave jo më vonë se 24 orë pas paraqitjes së kërkesës nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit⁴. Por, sikurse rezultoi nga kontakti me drejtuesit e policisë kësaj drejtorie, ky shqetësim vazhonte të ishte prezent dhe marrëveshja e bashkëpunimit ende nuk kishte gjetur zbatim në praktikë.

Qëndrimi i personave të ndaluar në këto kushte për një periudhë të pacaktuar dhe tej afateve ligjore, nuk përmbushë standardin e trajtimit njerëzor e me dinjitet të personave të ndaluar apo arrestuar sipas parashikimit të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Në ambientin e sigurisë, ndodhej zyra e përgjegjës të dhomave të sigurisë, e cila shërbente njëkohësisht dhe si zyrë për kryerjen e vizitave mjeksore nga mjeku/ndihmësmjeku i kësaj drejtorie. Ajo ishte e pajisur me orenditë e nevojshme si shtrat, tavolinë, karrige, raft dhe frigorifer për mbajtjen e medikamenteve mjeksore, si dhe pajisje për ngrohje.

Gjithashtu, në ambientin e sigurisë ishte dhe një dhomë për marrjen në pyetje të personave të ndaluarve/arrestuarve nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve, si dhe

³ Raporti CPT botuar më 17 shtator 2019. <https://rm.coe.int/168097986b>

⁴ Rekomandimi 1, faqe 8, përgjigje e Qeverisë Shqiptare në lidhje me rekomandimet e CPT. <https://rm.coe.int/16809cb571>

për takime me avokatët. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige të fiksuara në dysHEME në mënyrë të palëvizshme.

Mjediset brenda në ambientin e sigurisë dhe në pjesën e jashtme të tij, mbahen në vëzhgim dhe monitorohen nga sistemi i kamerave audio-vizive, filmime të cilat ruheshin për një afat një mujor dhe administroheshin nga IT e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Në koridorin e dhomave të sigurisë ishte i instaluar telefoni fiks, që shërben për komunikimin e punonjësve të shërbimit me zyrën e informacionit në rast nevojë, si dhe në muret e dhomave ishin të montuar buton zileje/sinjali për kontaktin e të arrestuarve/ndaluarve me punonjës të policisë.

Ngrohja e ambientit të sigurisë, sigurohej me kaldajë nga sistemi qëndror, i cili ndizej 3 herë në ditë sipas orareve të miratura nga drejtuesit e institucionit, sipas stinëve.

Në fundin e korridorit të dhomave të sigurisë, ndodheshin 2(dy) tualete të ndara më vete për femra dhe meshkuj. Ato kishin furnizim me ujë të rrjedhshëm për mbajtjen e pastërtisë të ambientit dhe higjienës vetjake. Në njërin prej këtyre tualeteve, ishte instaluar dushi me ujë të ngrohtë për larjen e trupit. Theksojmë gjithashtu se, në çdo dhomë kishte një hidro-sanitare më vete.

Dhomat e sigurisë kishin gjenerator si burim rezervë të energjisë në rast ndërprerje të energjisë elektrike.

Në tërësi ambienti i sigurisë plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në procedurat standarde, për trajtimin dinjitoz të shtetasve të arrestuar/ndaluar dhe kryerjen e detyrës nga punonjësit e policisë që kryejnë shërbim në këto ambiente.

Por, sikurse theksuam edhe më lart, disa nga problematikat e konstatuara në ambientin e sigurisë të DVP Tiranë mendohet se kanë të bëjnë me kapacitetin e ulët që kanë dhomat e sigurisë, kur dihet se dinamika e kësaj drejtorie në raport me drejtoritë e tjera të policisë është shumë e lartë, mungesën e hapsirës dhe sipërfaqes të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë në rastet e mbipopullimit, mungesa e dhomës më vehte për kryerjen e vizitave mjeksore, etj. Sipas drejtuesve të policisë të kësaj drejtorie, problematikat infrastrukturore, të cilat janë evidentuar edhe në raportin e CPT (European Committee for the Prevention of Torture)⁵, do të marrin zgjidhje me përfundimin e projektit të godinës/bllokut të ri të dhomave të sigurisë, që po ndërtohet pranë Komisarariatit të Policisë nr.3, Tiranë.

Në këto kushte, Institucioni jonë vlerëson hapat e ndërmarrë nga Policia e Shtetit për ndërtimin e objektit/bllokut të sigurisë për Drejtorinë/komisariatet e policisë Tiranë, sipas edhe angazhimit të qeverisë shqiptare në përgjigje të rekomandimeve të CPT. Por, njëkohësisht inkurajojmë përfundimin e punimeve nga ana e operatorit ekonomik, që ka marrë përsipër ndërtimin e këtij objekti brenda 24 muajve, sipas afatit kontraktor lidhur me Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë⁶.

⁵ Rekomandimi 8, faqe 14, përgjigje e Qeverisë Shqiptare në lidhje me rekomandimet e CPT. <https://rm.coe.int/16809cb571>.

⁶ Kontrata Nr.1412, datë 14.08.2019 me operatorin ekonomik "HASTOCI" shpk për ndërtimin e zonës së Sigurisë në DVP Tiranë.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Drejtorinë Vendore të Policisë, Tiranë, punonjësit e zyrës së informacionit plotësonin rregullisht “Regjistrin e evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”. Ky regjistër ishte sipas “Model nr.1”, të përcaktuar në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se ishte i sekretuar dhe rubrikat e tij ishin të plotësuara. Koha e qëndrimit të shtetasve në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit nga punonjësit e policisë të këtij komisariati evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte gjithashtu i sekretuar.

Avokatit të Popullit, në rastet e trajtimit të ankesave individuale, si dhe nga inspektimet e kryera për kqyrjen e regjistrave që administrohen nga organet e Policisë së Shtetit, ka rekomanduar se në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, duhet vihet ora e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë dhe jo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit. Ky rekomandim, zbatohet nga punonjësit e policisë që kryenin veprime procedurale me personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij, si dhe neni 109, pika 4 e ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Por, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së ka konstatuar gjatë vizitave inspektuese të kryera në vitin 2019 në ambientet e shoqërimit dhe sigurisë të DVP Tiranë, se në disa raste regjistri për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar është plotësuar me vonesë dhe jo në kohën e shoqërimit të personave në mjediset e policisë, duke u justifikuar me fluksin e madh të të shoqëruarve. Kjo, përbën shkelje të drejtave ligjore dhe procedurale të të shoqëruarve, pasi lihet hapsirë për abuzim apo fshehje të qëllimit të shoqërimit nga organi i policisë.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë.

Në kohën e inspektimit në dhomat e shoqërimit në Drejtorinë Vendore të Policisë, Tiranë, nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Ndërsa, në dhomat e sigurisë ndodheshin 12 persona, nga të cilët 10 persona të arrestuar/ndaluar ishin në moshë madhore dhe 2 femra.

Në kohën e inspektimit, grupi i monitorimit intervistoi personat e ndaluar/arrestuar, të cilët konfirmuan se ishin trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë.

Nga të intervistuarit nuk pati pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike e të intervistuarve ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasoja të shkaktuara nga keqtrajtimi. Të intervistuarit nuk dëshmuan frikë apo druajtje për të raportuar keqtrajtimin e tyre.

Shtetasit e intervistuar kishin dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishin marrë kontakt dhe kishin kryer veprimet procedurale. Ata shpjeguan se, gjatë

ndalimit/arrestimit punonjësit e policisë ishin identifikuar përpara tyre duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin.

Gjatë vitit 2019, Institucioni i Avokatit të Popullit ka kryer vizita inspektuese tematike, në rastin e shoqërimit dhe ndalimit të qytetarëve nga punonjësit e policisë të DVP Tiranë, menjëherë pas tubimeve të organizuara nga subjektet politike opozitare në Tiranë apo protestave të zhvilluara nga banorët në “Unazën e Re”, “Bregun e Lumit” etj. Nga inspektimi ka rezultuar se, janë shoqëruar dhe janë mbajtur në mjedisin e shoqërimit dhe në dhomat e sigurisë një numër i lartë i personave, duke krijuar mbipopullim në raport me hapsirat dhe sipërfaqet që kanë këto ambiente. Kjo praktikë, përbën për Avokatin e Popullit, trajtim degradues dhe shkelje të të drejtave të personave të arrestuar/ndaluar, të garantuara me aktet ligjore dhe nënligjore dhe dokumentet ndërkombëtare, për këtë qëllim.

Nga monitorimi i veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë që në momentin e shoqërimit të këtyre personave për në mjediset e policisë, koha e qëndrimit në ambientin e shoqërimit, marrja në pyetje dhe intervistimi i tyre, deri dhe shoqërimi për në dhomat e sigurisë, MKPT shpesh herë ka konstatuar se të drejtat e personave të shoqëruar nuk zbatohen në mënyrë të rregullt përgjatë orëve të shoqërimit në drejtorinë/komisariatet e policisë Tiranë.

Disa nga problematikat e konstatuara janë:

- Personat e shoqëruar/ndaluar nga policia shpesh herë në orët e para të shoqërimit, nuk kanë pasur qasje për avokat (e drejta për të pasur një avokat privat, të flasë me të dhe të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje)⁷. Qasja te një avokat shërben për qëllime të shumta plotësuese për personin e ndaluar, përfshirë përgatitjen e mbrojtjes dhe ruajtjen e procesit të rregullt ligjor.

- Personat e shoqëruar/ndaluar nga punonjësit e policisë nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se morën një kopje të fletës me të drejtat e tyre në përfundim të procesit së marrjes në pyetje në organin e policisë⁸. CPT i ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse përgjatë inspektimit të kryer në vitin 2018- të, se personat e shoqëruar/ndaluar duhet të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i privimit të lirisë (momenti i shoqërimit), duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/proceduriale që ata kanë që në fillim të privimit të lirisë. Sipas gjetjeve edhe të MKPT, fleta shpjeguese me të drejtat e personave të ndaluar u jepet atyre në fund të procesit të marrjes në pyetje.

- Personat e shoqëruar /ndaluar nga policia është konstatuar se kanë pasur vonesa në qasjen në kujdesin shëndetësor dhe kujdesin mjekësor duke u bazuar në dispozita të përcaktuara në manual/procedurë për trajtimin dhe sigurimin me rigorozitet për kryerjen e ekzaminimit fillestar.

- Gjithashtu, libri i ankesë/kërkesave shpesh herë plotësohet formalisht, jo në përputhje me kërkesat e neni 115, të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, pasi MKPT ka konstatuar raste kur persona të shoqëruar/ndaluar kanë relatuar pretendime për dhunë kur janë intervistuar nga ana jonë, por një gjë e tillë nuk është vlerësuar dhe nuk është gjetur

⁷ Ligji Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, Neni 109, pika 3

⁸ Komiteti European për Parandalimin e Torturës ju ka rekomanduar CPT/Inf (2019) 28⁸.

e pasqyruar në libër nga punonjësit e policisë që shërbejnë në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë të drejtorisë/komisariatet e policisë Tiranë.

Problematikat e evidentuara më lartë, kërkojnë rritjen e përgjegjshmërisë në kryerjen e detyrës nga ana e të stafit të punonjësve të policisë që shërbejnë në këto ambiente, por nga ana e drejtuesve të institucionit është e nevojshme kryerja e një trajnimi specifikisht për zbatimin e rekomandimeve të fundit të CPT-së dhe rekomandimeve të vazhdueshëm të MKPT-së për këto çështje.

Nga informacioni dhe intervistimi i personave të ndaluar/arrestuar rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr.432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi përgatitej dhe shërbehej me katering nga një subjekt privat, sipas një kontrate të lidhur mes institucionit dhe subjektit privat.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brënda dhomave të sigurisë.

Të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës. Theksojmë se, në aspektin e plotësimit të kushteve materiale për personat e ndaluar/arrestuar, duhet të merren masa nga sektori përgjegjës në këtë drejtori, për ndërrimin në kohë të bataniqeve të dëmtuara, si dhe larjen e shpeshtë të tyre, pasi nga inspektimi rezultoi se ato nuk ishin në gjendje të mirë përdorimi.

Ambientet e intervistimit

Në ambientin e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë kishte një dhomë më vete, e cila shërbente për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuarve nga prokurori dhe njëkohësisht për takime me avokatët privat.

Ndërsa, në ambientin e shoqërimit nuk kishte një dhomë më vete për marrjen në pyetje të shtetasve të shoqëruar në këto mjedise. Në këto kushte, oficerët e policisë gjyqësore kryenin intervistat/marrjen në pyetje të këtyre personave para se ata të ndaloheshin në ambientet e sigurisë të kësaj drejtorie, në zyrat e punës së tyre. Zyra për intervistim apo marrjen në pyetje të shtetasve të shoqëruar dhe në mungesë të tyre zyrat e punës të punonjësve të policisë, që kryejnë veprime procedurale me këta persona, duhet të jenë të monitoruar me sistemin e kamerave.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre⁹.

⁹ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë që u ndodhën në këtë komisarjat nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj personave me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret, në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë, Tiranë, ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar, por ishte e nevojshme të rifreskohen me postera të rinj.

Sipas punonjësve të policisë, të ndaluarit/arrestuarit dhe të shoqëruarit njiheshin me të drejtën për të pasur një avokat mbrojtës gjatë marrjes në pyetje, dhe ata që e kishin kërkuar iu ishte krijuar mundësia për të kontaktuar me të. Nga pyetja e punonjësve të policisë dhe intervistat me personat në dhomat e sigurisë, rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pasur avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre ju sigurohej avokat mbrojtës nga lista e afishuar e organit të prokurorisë në ambientin e sigurisë, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë, u konfirmua edhe nga pyetja/intervistimi i të arrestuarve/ndaluarve, të cilët deklaruan se ishin njohur me të drejtat ligjore nga punonjësit e policisë kur ishin marrë në pyetje dhe ishin takuar me avokatët e tyre.

Gjithashtu, u konstatua gjatë inspektimit se personave të ndaluar/arrestuarve iu ishin dhënë nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të kartës me të drejtat e tyre.

Në rastin e personave të shoqëruar në mjediset e policisë, Komiteti CPT dhe MKPT pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, synojnë të vendosin standarde më të larta duke rekomanduar se, njohja me të drejtat ligjore dhe proceduriale, si dhe pajisja me kartën e të drejtave të këtyre personave, duhet të bëhet që në momentin kur këtyre personave ju privohet liria, praktikë e cila ndiqet vetëm për personat e ndaluar/arrestuar.

Për shtetasit e huaj të arrestuar/ndaluar komunikimi me punonjësit e policisë dhe prokurorin bëhet në gjuhën amtare apo në një nga gjuhët që ata kuptojnë nëpërmjet avokatit mbrojtës dhe një përkthyesi. Po ashtu, për këta persona kishte karta me të drejtat e tyre të përkthyer në 10 nga gjuhët e huaja më kryesore.

Sipas informacionit të drejtuesve të policisë të kësaj drejtorie, në rastin kur personi është i mitur në konflikt me ligjin, ai gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, të drejtat e parashikuara në procedurën standarde¹⁰, si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. Nga momenti i shoqërimit në mjediset e policisë, personi i mitur merret në pyetje/intervistohet i shoqëruar nga kujdestari i tij ligjor, avokati mbrojtës dhe psikologu. Avokati mbrojtës sigurohet nga lista e avokatëve, ndërsa psikologu ishte në organikë të DVP Tiranë.

Në ambientet e DVP Tiranë **nuk** kishte dhomë më vete intervistimi apo marrjes në pyetje të të miturve, me kushte të përshtatshme, sistem ajrosje dhe ndriçim të plotë natyral dhe artificial (elektrik), sikurse përcaktohet në procedurën standarde dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

¹⁰ *Kreut IV, pika 1 e procedurave standarde: "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre".*

Të arrestuarve/ndaluarve u ishte bërë vizita mjekësore brënda afatit 12 orë nga mjeku/ndihmësmjeku i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë,¹¹ i cili ishin të punësuar me kohë të plotë. Vizitat mjekësore, rekomandimet dhe mjekimet regjistroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore që mbahej nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë të këtij komisariati.

Mjeku mbulonte dhe vizitat mjekësore në dhomat e sigurisë në komisariatet e policisë në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Për shkak të ngarkesës, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka vite që ka rekomanduar shtimin në organikë edhe një mjek të përgjithshëm për mbulimin në kohë të vizitave mjekësore në ambientet e sigurisë të organeve të policisë që janë në varësinë e kësaj drejtorie, i cili ende nuk ka gjetur zbatim.

Gjithashtu, në dhomat e sigurisë mbahej dhe plotësohej regjistri i kërkesë/ankesave të personave të arrestuar/ndaluar, por për vitin 2019 nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë nga këta persona, ndonëse ka patur disa raste të përdorimit apo tejkalimit të dhunës nga punonjësit e policisë, të cilët janë çuar për hetim nga organi i prokurorisë gjatë këtij viti. Në këto kushte, kjo çështje duhet të trajtohet me shumë prioritet nga ana e strukturave drejtuese të drejtorisë/komisariateve të policisë Tiranë, si dhe për të bërë me dije këtë fakt dhe për të ndaluarit/arrestuarit, me qëllim që mekanizmi i kërkesë/ankesave të bëhet sa më efektiv.

Nga verifikimi i dokumentacionit, u konstatua se, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde “Regullat teknike të shoqërimit në polici”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin në ambientin e shoqërimit të dhomës (zyrës) për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar nga oficerët e policisë gjyqësore, para se ata të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe instalimin brenda saj të sistemit të monitorimit me kamera.
2. Marrjen e masave për krijimin e një ambienti më vete për intervistimin apo marrjen në pyetje të të miturve, me kushte të përshtatshme dhe i pajisur me orëditë e nevojshme.
3. Marrjen e masave të menjëherëshme, për të garantuar organizimin e punës në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në minimizimin e mbipopullimit për situata kur numri i të shoqëruarve dhe të ndaluar/arrestuar, mund të jetë tej kapaciteve që disponon ky institucion.

¹¹ Kreu II, pika 7/b e procedurave standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

4. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin në ambientin e sigurisë të një mjedisi më vete, e cila të shërbejë si dhomë e mjekut, për kryerjen e vizitave mjeksore të personave të ndaluar/arrestuar dhe të jetë e plotësuar me orenditë e nevojshme sipas procedurës standarde për trajtimin dhe sigurimin e këtyre personave.
5. Marrjen e masave të nevojshme për shtimin në organikë të një mjeku të përgjithshëm me kohë të plotë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, për të përballuar në kohë kryerjen e vizitave mjeksore të personave të ndaluar/arrestuar në drejtori dhe të gjitha komisariatet në varësin e saj që kanë dhoma sigurie.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për vendosjen në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, të posterave të rinj me të drejtat që gëzojnë personat që ju privohet liria në mjediset e policisë.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për lyerjen dhe dizifiktimin e dhomave që ndodhen në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për trajtimin e stafit të punonjësve të policisë që shërbejnë në ambientin e shoqërimit dhe ambientin e sigurisë, në lidhje me rekomandimet e bëra nga CPT në raportin e botuar në 17 Shtator 2019 për Shqipërinë, si dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brënda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFA